



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Malishevës

31 Dhjetor 2010

# Përmbajtja

	Page
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Të përgjithshme	6
Të gjeturat e vitit aktual	7
Të gjeturat e vitit të kaluar	17
Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit për vitin 2010	23
Pasqyrat Financiare për vitin që përfudon me 31 Dhjetor 2010	26
Politikat Kontabël	28

## Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Kryetarin e komunës Malishevë, Kosovë

### Raporti mbi Pasqyrat Financiare

**Grant Thornton LLC**  
Rr. Rexhep Mala 18  
10 000  
Pristina  
Kosovo  
T +381 38 247 771  
+381 38 247 801  
F +381 38 247 802  
[ëëë.grant-thornton.com.mk](http://ëëë.grant-thornton.com.mk)

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare shoqëruese të Komunës së Malishevës (“Komuna”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010, Raportin e ekzekutimit të buxhetit, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

#### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Udhëzimin Administrativ nr 16/2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe me Instruksionet administrative Nr. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009, dhe për këtë menaxhmenti përcakton kontrollet e brendshme të nevojshme që të mundësojë përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafët Bazat për Mohim të Opinionit, ne nuk ishim në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit në mënyrë që të sigurojmë një bazë për opinion të auditimit.

### *Bazat për Mohim të Opinionit*

1. Ne nuk na janë ofruar dokumente mbështetëse të mjaftueshme dhe adekuate lidhur me pagesat nga palët e treta, duke përfshirë edhe dokumentet lidhur me shpërndarjen e mjeteve të kontribuara për komunën. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës alternativ ne nuk ishim në gjendje që të sigurojmë veten tonë si për ekzistencën, plotësinë, vlerësimin dhe prezantimin e pagesave dhe faturave përkatëse për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010.
2. Komuna nuk ka shpalosur në Shënimin 27 të pasqyrave financiare ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet. Për shkak të natyrës së regjistrave, ne nuk kemi mundur të jemi të kënaqur me kompletimin, korrektësinë dhe vlerësimin e pronës, impiantit dhe paisjeve të Komunës për 31 Dhjetor 2010.
3. Disa shpalosje të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Udhëzimi Administrativ nr 2010/16 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë bërë nga ana e Komunës në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010. Në veçanti, çështjet në vijim janë lënë jashtë ose shpalosur në mënyrë të gabuar në pasqyrat financiare:
  - Shpjegime për dallimet materiale ndërmjet buxhetit dhe shumave aktuale të realizuara nga shënimin 17 deri 23.
  - Neni 13 Shënimin 25 Pasqyra e detyrimeve të faturave të papaguara në shumë prej 234,424 euro nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare.
  - Shënimin 28 Të arkëtueshmet, komuna nuk ka shpalosur asnjë shumë në Pasqyrat Financiare.

Prandaj, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme lidhur me plotësinë dhe përputhshmërinë rregullatore të informatave financiare të paraqitura në pasqyrat financiare të komunës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010.

### *Mohim i Opinionit*

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin Bazat për Mohim të Opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit për të ofruar bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare.

### *Theksim i çështjes*

Ne i kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

Mangësitë dhe pasiguritë lidhur me raportimin financiar për pronat, objektet dhe pajisjet e Komunës janë identifikuar si më poshtë:

- Komuna nuk mban regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë

### **Raporti për kërkesat tjera Ligjore dhe Rregullative**

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë reflektuar në të gjitha aspektet materiale, në pasqyrat financiare në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me ato të hartuara për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

### ***Përgjegjësia e auditorit***

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për konkluzionet tona.

### ***Konkluzion për Përputhshmërinë***

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

### ***Çështje të tjera***

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- a) Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Komuna nuk ka zbatuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.
- b) Edhe pse kryetari e kishte nënshkruar deklaratën lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ishte në gjendje të japë një version përfundimtar të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.
- c) Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme. Në vend të saj vetëm mbledhjet e parasë së gatshme nga niveli i të hyrave janë regjistruar. Sipas urdhëresës administrative për 2010, të gjitha llogaritë e arkëtueshme duhet të shpalosen në Pasqyra Financiare. Mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë,



për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.

- d) Komuna nuk ka mbajtur lista të plota të pagesave nga palët e treta. Evidenca e disponueshme dhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për tu siguruar se pagesat nga palë të treta prezantohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe përdoren për qëllimin e synuar nga legjislacioni, ishin të limituara.
- e) Ne identifikua një numër mospërputhjes me Ligjin Nr 02/L-99, Rregulloren Nr.2007/20 e cila rrjedh nga Rregullorja e prokurimit 2003/17 për publikimin e amendamenteve për Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë". Të tilla jo-pajtueshmëri kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit të kërkuara të cilat nuk janë kryer dhe dokumentuar nga Komuna.
- f) Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundshme që pagesa të parasë së gatshme të kërkojnë në të ardhshmen e afërt, Komuna nuk ka hartuar dhe zbatuar asnjë procedurë për informacion të plotë, të saktë dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

#### **Grant Thornton**

Prishtinë,  
28 Shkurt 2011

# Shtesa I

## Letër Menaxhmenti

# Të përgjithshme

## Auditimi për 2010

Grant Thornton është emëruar për të ushtruar auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Malishevës (“Komuna”) të përgatitura në pajtueshmëri me bazë në para të gatshme SNKSP Raportimi Financiar në Para të Gatshme, për vitin që mbaron me 31 Dhjetor 2010.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuara në vazhdim dhe bazohet në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i kompletuar apo i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e kështillës sonë, ne jemi duke u mbështetur në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve në mënyrë retroaktive dhe/apo prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të azhurnojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

## Pasoja

Ky raport është dizajnuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e këtyre dobësive dhe në qoftë se ju dështoni të bëni një gjë të tillë, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

## Përfundimi i mashtimit

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët, ju nuk duhet, përveç rasteve të neglizhencës sonë, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, të na quani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose pasojë tjetër në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtrore.

## Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është e përshkruar në një faqe të veçantë. Për çdo vëzhgim struktura është: të gjeturat, risku, rekomandimi dhe Komentet e Menaxhmentit.



# Të gjeturat e vitit aktual

## 1 Përgatitja e pasqyrave financiare

### Të gjeturat

Informacioni parësor i besueshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFKSIMFKBalanci. Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në faqe të ekselit , që nuk janë përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Për me tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e programit të integruar të kontabilitetit:

- pagesat nga palët e treta
- faturat e pa paguara (detyrimet)
- prona, objektet dhe pajisjet dhe
- llogaritë e arkëtueshme.

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Ne nuk u pajisëm me dokumentacionin mbështetës të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm ose dokumente të tjera ligjore lidhur me pagesat e bëra për kompensimin e stafit në dhjetor 2010. Në mungesë të dokumentacioneve mbështetëse alternative, ne nuk ishim në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme mbi saktësinë e pagesave të Komunës për pagat dhe mëditjet.
- Neni 10 Raporti i ekzekutimit të buxhetit. Shuma e paraqitur në kolonën e buxhetit fillestar në raport nuk përputhet me shumën e Buxhetit të aprovuar.
- Shënim 30 Harmonizimi në mes të ndarjeve buxhetore fillestare dhe përfundimtare. Shënimi i paraqitur nuk është shpalosur si duhet.
- Shënim 12 Të hyrat vetanake. Shënimi 12.1 nuk mund të lidhet me Shënimin 12.
- Shënim 13 Grantet, nuk mund të lidhet me nenin 10, Raporti i ekzekutimit të buxhetit.
- Shënim 16. Grantet tjera qeveritare, nuk mund të lidhen me nenin 10, Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

**Key findings, recommendations and Management's comments**  
31 December 2009

- Ne po ashtu kemi vënë re që qeraja e arkëtueshme / të hyrat në bazë të kontratës së qerasë me numër 03/4608 të datës 25.08.2006, nënshkruar në mes të komunës së Malishevës dhe BEN-AF Sh.p.k Suhareka për obligimin mujor prej Euro 38,000 nuk ishte faturuar dhe regjistruar në SIMFK. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga personat përgjegjës për implementimin e kontratës.
- Neni 10, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, shënimi 12, të hyrat vetanake në Pasqyra Financiare nuk është shpalosur siç duhet, pasi që komuna ka regjistruar shumën prej Euro 129,213 në SIMFK, përderisa në Pasqyra Financiare është regjistruar shuma prej Euro 98,212 që përfaqëson gjokat e trafikut dhe të gjykatës.
- Neni 13 Shënimi 25 Pasqyra e detyrimeve të faturave të papaguara nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare.
- Neni 15, Shënim 27, nuk ka Asete jo-financiare në pronësi të organizatës buxhetore të shpalosura në Pasqyra Financiare në pajtueshmëri me termet e nenit 15 të urdhërësës administrative 16/2010.
- Mund të ketë pagesa të konsiderueshme nga palët e treta, (për shembull kur një palë tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë me një pasuri për përdorim nga Komuna), që nuk mund të regjistrohen në pasqyra financiare sepse nuk janë regjistruar në SIMFK;
- Neni 16, Shënimi 29 Detyrimi kontingjent nuk është i përfunduar.
- Neni 12, numri i personelit në Komunë nuk paraqet një prezantim të duhur të numrit të punëtorëve sipas secilit drejtorat.

### **Risku**

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve si në vijim:

- Plotësia dhe saktësia e informacionit financiar;
- Integriteti i të dhënave;
- Ruajtjen e pasurive; dhe
- Mungesa e regjistrimit të pagesave nga palë të treta mund të rezultojë në pasuri/shërbime të përdorura pa qera nga palë të tjera, të ndryshme nga Komuna.

### **Rekomandim**

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

### **Komentet e Menaxhmentit**

1. Në lidhje me pikën 1 të gjeturave në vitin aktual 2010 për pagesat e bëra të stafit në dhjetor, ne kemi ofruar vendimin e kryetarit të Komunës për stimulimin e punëtorëve për punën e bërë shtesë shpeshherë pas orarit e sidomos të punëtorëve të ofiqarisë, inspektoratit dhe të tjerëve gjatë kohës kur bashkëatdhetarët e shumë duhej të pajiseshin me dokumentacion të ndryshëm. Pra ishte e nevojshme të punohej me orar të zgjatur.

**Key findings, recommendations and Management's comments**  
**31 December 2009**

2. Këtu shënimi 13 është përfshirë në shënimin 16 si Grant i qeverisë pasi që në fund është përfshirë në shënimin 21 si shpenzime kapitale.

3. Shënimi 30. Mospërputhja në mes të ndarjeve fillestare dhe përfundimtare është si rrjedhim i transferit të QPS nga niveli qendror në atë lokal, të pylltarisë si dhe ndryshimit në paga të punëtorëve të shëndetësisë, të zjarrfikësve dhe pagesat e shujtave në fund të vitit.

4. Shënimi 12 të hyrat vetanake nuk lidhen me shënimin 12.1 vetëm për shkak të mos ekzistimit të pozicioneve të shënuara në shënimin 12.1 ku më të theksuara janë vetëm taksat e ndryshme komunale.

Të gjitha të hyrat e inkasuara nga komuna janë dhënë analitikisht në F-38 raporti i pranimeve sipas programeve.

5. Neni 10. Komuna nuk e ka regjistruar këtë shumë 129.213 € pasi kjo shumë nuk është e hyrë e Komunës si dhe është alokuar pas përgatitjes së pasqyrave financiare dhe ishte donacion I BE për një projekt.

6. Tek shënimi 25 ne vetëm kemi bashkangjitur listën e obligimeve të konstatuara me 31.12.2010.

7. Shënimi 27. Meqenëse nuk është bërë vlerësimi I asetëve jo-financiare nuk kemi mundur që ti shpalosim të njëjtat.

Të gjeturat e vitit aktual (vazhdim)

## **2 Menaxhimi i pronave, objekteve dhe pajisjeve**

### **Të gjeturat**

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë, mbi patundshmëritë dhe informacion për statusin e regjistrimeve në emrin e Komunës në Regjistrin lokal për patundshmëri ose në Gjykatë.

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë nga ana e Komunës nuk ka përfunduar. Gjatë këtij viti Komuna ka caktuar një person përgjegjës për pasuri, Znj. Visare Maloku e cila e ka ndjekur një trajnim në lidhje me menaxhimin e pasurisë. Gjithashtu gjatë vitit 2010 Komuna ka themeluar një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, i cili komision nuk ka kryer asnjë aktivitet në lidhje me regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë.

Ministria e ekonomisë dhe financave (MEF), departamenti I thesarit (DT), në bazë të instruksionit administrativë nr. 21/2009 ka kërkuar nga të gjitha organizatat buxhetore (OB) të sqarojnë cilën metodë të vlerësimit e kanë shfrytëzuar për vlerën bartëse të mjeteve fikse të paregjistruara në vitet e kaluara. Kjo kërkesë nuk është përmbushur nga Komuna për vitin aktual.

Ne nuk na është ofruar ndonjë evidencë e numërimit të stoqeve të aseteve më 31 Dhjetor 2010.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Shpalos informacionin mbi pronën, ndërtesat dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009; dhe
- Të sigurojë harmonizim të informacionit të regjistruar në regjistrat kontabël me tabelat e vlerësimit apo me ndonjë analizë tjetër, përpara aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

### **Risku**

Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të patundshmërive, pronave dhe pajisjeve e dobëson kontrollin e brendshëm mbi këto pasuri dhe mund të çojë deri te keqpërdorimi i pasurive dhe mos identifikimi i këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur. Për më tepër, menaxhmenti mund të humbasë kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën e bartur të pasurive gjatë proceseve vendim-marrëse.

Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledh të hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të aseteve të saj, Komuna mund të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat për raportim.

#### Të gjeturat e vitit aktual (vazhdim)

#### Rekomandimet

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbajë një regjistër gjithëpërfshirës të patundshmërive, pronës dhe pajisjeve.
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar është e rekomandueshme si praktika më e mirë në raste të tilla.
- Të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e aseteve dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe në regjistër.
- Të përfshijë blerjet dhe përmirësimet pasuese në vlerën bartëse të aseteve.

#### Komentet e menaxhmentit

Këtë vit kemi trajnuar zyrtarin e pasurisë i cili është duke punuar në regjistrimin e pasurisë së Komunës.

### **3 Të hyrat**

#### Të gjetura

- Harmonizimi në mes të departamentit të financave dhe departamenteve tjera. Harmonizimi ndërmjet zyrtarit për të hyra vetanake dhe departamentit të thesarit është bërë çdo tremujor për gjithë shumën e të ardhurave. Gjatë vitit 2010 ne kemi identifikuar që nuk është bërë asnjë harmonizim në mes të dhënave në kontabilitet, të siguruar nga zyrtari për të ardhurat vetanake dhe departamentet operationale. Si rrjedhojë, ekzistojnë diferenca nëse i krahasojmë të dhënat nga këto dy departamente.
- Regjistrime të sakta brenda kodeve ekonomike të të hyrave. Bazuar në testimet tona të dokumenteve burimore lidhur me të ardhurat e caktuara, ne kemi identifikuar që jo të gjitha regjistrimet janë prezantuar me kodet e duhura ekonomike.
- Sistemi i faturimit. Një sistem automatik faturimi ekziston vetëm për tatimin në pronë. Për kategoritë e tjera të të ardhurave për të cilat sistemi i faturimit është i kërkuar, nuk aplikohet. Përveç ngarkesave për regjistrimin e bizneseve të cilat mbahen në programin "Access", faturimi i Komunës nuk regjistrohet, në vend të asaj mbledhjet në para nga të ardhurat e tilla regjistrohen.
- Mangësitë në sistemin e faturimit. Gjatë vitit 2010 dhe 2009 sistemi i faturimit i tatimit në pronë ishte centralizuar dhe komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave siç ishte bërë në mënyrë automatike nga sistemi i ri. Mund të ndodh që konsumatori ka paguar tatimin në pronë, por shuma e grumbulluar nuk është regjistruar në sistem dhe klienti është ngarkuar me dënim (interesa) edhe pse tatimi është paguar me kohë.
- Sipas rregullores për tatimin në pronë, të gjitha pronat e reja të identifikuara deri në fund të Marsit ngarkohen për vitin aktual, përderisa pas 31 Marsit ngarkohen në vitin vijues. Kjo është për shkak të organizimit të sistemit të faturimit për dërgimin e faturave në Mars, që rezultojnë me ngarkesë në vitin vijues për pronat e reja të regjistruara prej Prillit deri në Dhjetor.

#### Të gjeturat në vitin aktual

- Të hyrat nga licencat e biznesit. Komuna nuk merr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë numrin total të bizneseve aktive në Komunë. Për më tepër, Komuna nuk mban një regjistër të duhur të bizneseve të cilat operojnë në Komunë. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga Komuna për ta konfirmuar numrin e bizneseve të cilat operojnë në Komunë me listën e bizneseve sipas autoriteteve tatimore ose qendrës për regjistrimin e bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
- Ndarja e detyrave. Bazuar në auditimin tonë, ne kemi identifikuar që Arkatari i njëjtë që mbledh paratë e gatshme i depoziton ato para në bankë. Nuk ka pasur harmonizim në mes të dokumentacionit dhe parasë së mbledhur si dhe kontroll mbi paranë e mbledhur dhe të deponuar në bankë nga personi përgjegjës në Komunë.
- Pamundësia për të ndjekur dhe menaxhuar llogaritë e arkëtueshme. Faturat për shërbimet që nuk janë të lidhura me tatimin në pronë nuk regjistrohen. Në lidhje me të gjitha të ardhurat, përveç tatimit në pronë, nuk mbahen regjistra të borxhlinjve.

#### Risku

Edhe pse për të arkëtueshmet kërkohet shpalosja në pasqyrat financiare, po ashtu mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë mbi të ardhurat që Komuna mund të fitojë. Pa të dhëna të mjaftueshme, të detajuara dhe të sakta të debitorëve dhe raporteve në arkëtimeve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportoje normën e saktë të arkëtimeve ose të përcjell në kohë arkëtimin e të ardhurave vetanake burimore. Gjithashtu, arkëtimi i ulët i të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin investues të Komunës.

Kontrolle jo të përshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat, softuerin dhe sistemin e faturimit, e rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të informacionit. Një sistem i tillë mund të çojë në faturim jo të plotë dhe të ardhura jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e lidhjes së sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë automatike, e ekspozon Komunën ndaj një rreziku shtesë të gabimit. Për më tepër, kjo shkakton kosto shtesë për mbajtjen e të dhënave, rishikimin dhe harmonizimin e informacionit.

Një listë e detajuar dhe e përditësuar e tatim paguesve, bizneseve aktive dhe debitorëve të gjeneruar nga sistemi është me rëndësi të veçantë në situatën e tanishme ku komunat nuk e regjistrojnë secilin transaksion individual në SIMFK. Si pasojë, përveç për tatimin mbi pronë, Thesari dhe Komuna, nuk kanë një listë të detajuar të gjeneruar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat i kësaj, nuk është e mundur të bëhen harmonizimet e nevojshme ose analiza sipas debitorëve.

Edhe pse gjetjet e mësipërme nuk kanë një ndikim material në pasqyrat financiare, Komuna është në kundërshtim me kërkesat e Rregulloreve të miratuara.

**Të gjeturat në vitin aktual (vazhdim)**

**Rekomandimet**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do të mundësonte Menaxhmentit monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mëdha dhe sigurimin që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës:

- a. Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe shkallën e arkëtimeve. Informatat e tilla duhet të jenë në dispozicion vetëm për një numër të kufizuar të personave dhe me autorizimin e Menaxhmentit.
- b. Menaxhmenti i lartë duhet të ndërmarrë hapa të nevojshme që të ushtrohen kontrolle të brendshme në lidhje me faturimin, regjistrimin, harmonizimin, marrjet e parave dhe raportimin e të ardhurave vetanake të Komunës.
- c. Të vendosë dhe të kontrollojë tarifrat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- d. Të ekzistojë një lidhje automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- e. Të kryej harmonizime të rregullta në mes të dy sistemeve për të gjitha llojet e të ardhurave. Çdo diferencë harmonizimi duhet të hulumtohet dhe të zgjidhet brenda një afati të caktuar.
- f. Të lidhen automatikisht zyra operative me atë të faturimit dhe të bëhen harmonizime të rregullta në mes tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operative. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.
- g. Të sigurohet një ndarje e përshtatshme e detyrave që kanë të bëjnë me mbledhjen e parasë. Punëtori që është përgjegjës për mbledhjen e parasë duhet të jetë i ndryshëm me punëtorin që kontrollon balancën në fund të ditës dhe që i depoziton në bankë
- h. Të inspektohen licenca komunale të punës së bizneseve dhe të ripërtërihen kur atyre u ka skaduar afati.
- i. Ne rekomandojmë që Kryetari të siguroj që Komuna do ndërmerr hapat e mëtejshëm për të përmirësuar kontrollin mbi të hyrat dhe në mënyrë rigoroze të punoj në përputhje me kërkesat e rregullores komunale.

**Komentet e Menaxhmentit**

Sa i përket efikasitetit në grumbullimin, menaxhimin dhe harmonizimin e të hyrave vetanake në mes të drejtorive Komuna ka hartuar një plan të harmonizimeve në mes të të gjitha drejtorive për të gjitha të ardhurat e grumbulluara. Sikurse që ne e bëjmë harmonizimin me thesarin qendror ne do të rregullojmë edhe harmonizimin me drejtorit e komunës.

Të gjeturat në vitin aktual (vazhdim)

#### **4 Shpenzimet**

Të gjeturat

*Pagat dhe mëditjet*

Mungesa e azhurnimit në kohë e listës së punëtorëve. Në rastin e dorëheqjes nga puna, duhet një muaj për të azhurnuar listat e punëtorëve dhe si pasojë punëtorët mund të marrin edhe një rrogë edhe nëse ai / ajo nuk është më zyrtarisht pjesë e atij institucioni.

Komuna iu ka paguar disa të punësuarve një kompensim shtesë që varijon nga 50-200 euro për muajin Dhjetor. Ne nuk kemi pranuar ndonjë vendim të mjaftueshëm dhe adekuat ose dokumente ligjore lidhur me pagesat e mësipërme si kompensim. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës alternativ ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë një siguri të arsyeshme lidhur me plotësinë dhe pajtueshmërinë e Komunës me rregullore.

Gjatë rishikimit të dosjes së personelit ne kemi gjetur se disa nga dokumentet në dosje mungonin. Lista e dokumenteve të tilla që mungonin është si vijon:

- Vlerësimi i intervistës për rekrutimin
- Përshkrimi i punës
- Raporti i vlerësimit për punën e bërë në fund të vitit (për të gjithë punëtorët)
- Vlerësimi për nevojat për trajnim
- Çertifikata të trajnimit dhe kurseve

*Prokurimi*

Gjetjet

Bazuar në ekzaminimin tonë të dokumentacionit burimor të ndërlidhur me procedurat e tenderit të aplikuara në Komunë, ne kemi identifikuar parregullsi të caktuara, si vijon:

- Gjatë procedurave të prokurimit, Komuna jo gjithmonë përdorë formën standarde të kontratave që janë pjesë e dokumenteve ofertuese dhe që përfshin të gjitha termet e nevojshme të përgjithshme dhe speciale të kontratës. Forma standarde e kontratës është Pjesa B e dosjes së tenderit për mallra dhe shërbime.  
(Nr. i Prokurimit: 62500 09 273 121; 62500 10 001 121; 62500 10 005 521; 62500 10 007 521; 62500 10 076 521; 62500 10 113 136; 62500 10 106 121' 62500 10 065 236).
- Ne nuk na janë ofruar dëshmi të mjaftueshme që ofertuesit dhe fituesi i kontratës janë informuar për rezultatet e tenderit, siç edhe është kërkuar nga neni 29 i Rregullës B të Prokurimit Publik. Nëse Komuna dështon të përmbush procedurat e parashikuara nga Ligji për Prokurim Publik ("LPP") dhe Rregulla B e prokurimit publik, është e ekspozuar ndaj riskut të transparencës dhe dyshimit të aktivitetit të prokurimit nga ndonjë ankesë e operatorëve ekonomik ose agjensionit të mbikëqyrjes së prokurimit si p.sh. PRB ose PPRC.  
(Nr. i prokurimit: 62500 09 273 121; 62500 10 001 121; 62500 10 005 521; 62500 10 007 521; 62500 10 076 521; 62500 10 113 136; 62500 10 106 121' 62500 10 065 236).
- Për furnizim të prokurimit me vetura me vlerë të kontraktuar prej 49,950 Euro, kontrata e nënshkruar, takimet e komisionit për pranim teknik të automjeteve dhe marrja e raportit dhe pranimi teknik i veturave janë nënshkruar në ditën e njëjtë. (Nr. i prokurimit: 62500 10 001 121.).



#### Të gjeturat në vitin aktual (vazhdim)

- Në nenin IV të dosjes së tenderit të lëshuar për operatorët ekonomik kriteret e dhënies së kontratës duhet të cekën. Duhet të jetë vetëm një kriter i përcaktuar (çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm përcaktuar nga kriteri i peshimit) Ka raste kur të dyja kriteret cekën në dosjen e tenderit. (Nr. i Prokurimit: 62500 10 001 121; 62500 10 005 521)
- Sipas nenit 60 të LPP dhe Pjesës së III.2.2 të dokumenteve standarde të ofertimit para së ta nënshkruajnë kontratën, operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë garancionin e ekzekutimit në vlerë jo më pak se 10% të vlerës së kontratës dhe ky garacion i ekzekutimit duhet të mbulojë tërë periudhën e ekzekutimit të kontratës. Ka pasur dosje ku garacioni i ekzekutimit nuk ka mbuluar periudhën e paraparë me kontratë. (Nr. i prokurimit 62500 10 005 521, 62500 10 007 521)
- Kontratat e ndërtimit të nënshkruara nuk përmbajnë terme të paracaktuara të pagesave siç është theksuar në nenin 26 deri 28 të dosjes së tenderit sipas kushtit special të artikullit 12. Nr. i prokurimit: 62500 10 005 521; 62500 10 007 521.

#### Ndikimi

Mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimet nga autoritetet ose dokumentacioni jo i kompletuar në dosjet e prokurimit mund të sjellin mospërputhje me ligjet gjithashtu edhe me kërkesat e Kontratës me qëllim që të shmangim humbje të rëndësishme që mund të ndodhin në pasqyrat financiare të Komunës.

#### Rekomandim

Komuna duhet të krijojë procedura adekuate të mjaftueshme të kontrollit për monitorim efektiv mbi tërë procedurën e tenderit në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

#### Komentete e Menaxhmentit

Nuk ka komente

## **5 Auditimi i brendshëm**

### Gjetjet

- Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi.

Gjatë periudhës së përfunduar me 31 Dhjetor 2010, auditimi I brendshëm ka performuar vetëm dy (2) auditime të brendshme (nga 5 sa ishin të planifikuara), dhe ato i referohen vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2009. Nuk janë bërë auditime sipas planit të aprovuar për vitin 2010.

#### Ndikimi

Mungesa e një Komiteti Auditimi dhe mos-zbatimi i planit të aprovuar të auditimit, rrit rrezikun e dështimit të kontrolleve të brendshme që në mënyrë të rëndësishme ndikon në raportet financiare të Komunës.

#### Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurojë që Komuna do të konsiderojë krijimin e një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë relevante me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të qeverisjes së korporatës. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në:

#### Të gjeturat në vitin aktual (vazhdim)

- Procesin e Kontabilitetit dhe raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhmenti;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që të sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditimit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditimit të brendshëm.

Për më tepër, auditimi i brendshëm duhet të punojë konform planit të aprovuar të auditimit të brendshëm për vitin 2010.

#### Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

## 6 Subvencionet dhe transfertat

### Gjetjet

Bazuar në ekzaminimin tonë, shpenzimi bazuar në vendimin 01/172 i datës 13.04.2010 nga Kryetari i Komunës për dokumentet që japin udhëzime të Komunës, në vlerë prej 900 Euro me nr. të referencës 16100267, kemi gjetur që ky shpenzim duhet të klasifikohet nga subvencioni dhe transferet në kategorinë e mallrave. Tutje, ne nuk kemi qenë të siguruar me dëshmi të mjaftueshme lidhur me natyrën dhe sasinë e dokumenteve të cilat është kryer lektorimi.

Transferet në vijim janë kryer bazuar në vendimin e bërë nga Kryetari i Komunës:

- UNION-i Blind 1,000 Euro
- Shoqata e veteranëve të luftës 5,000 Euro
- Klubi i atletikës “Malisheva” 500 Euro
- Shoqata e Biznesit “Malasi” 1,000 Euro.

Komuna nuk ka zhvilluar politikë të shkruar për kritere të subvencionit dhe nuk është kryer asnjë monitorim mbi fondet e transferuara (përdorimin e fondeve).

### Ndikimi

Mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimet nga autoritetet ose dokumentacioni jo i kompletuar mund të sjellin mos përputhje me Ligjet ose kërkesat e Kontratës dhe tek shpërdorimi i aseteve dhe gabimeve në pasqyrat financiare.

### Rekomandimi

Komuna duhet të zhvillojë politika dhe procedura të shkruara për subvencionet dhe transfertat dhe duhet të themelojë procedura adekuate të mjaftueshme të kontrollit për monitorim efektiv mbi përputhshmërinë me politikat dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

#### Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

## Të gjeturat e vitit të kaluar

### 1 Përgatitja e pasqyrave financiare

#### Të gjeturat

Informacioni parësor i besueshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFK. Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në Excel, që nuk janë përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet tek pasqyrat financiare.

Megjithëse Kryetari i Komunës ka nënshkruar Deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën Angleze dhe Serbe para fillimit të auditimit tonë. Gjatë periudhës së auditimit ne shpenzuam kohë dhe burime të konsiderueshme në asistimin e Komunës për të përmirësuar prezantimin e pasqyrave financiare në gjuhën Angleze. Sidoqoftë Komuna nuk ishte në gjendje të dorëzonte një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën Serbe në fund të auditimit tonë.

Për me tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një programi të integruar kontabiliteti:

- pagesat nga palët e treta
- faturat e pa paguara (detyrimet)
- prona, objektet dhe pajisjet.

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Shpjegime për dallimet materiale ndërmjet buxhetit dhe shumave aktuale nga shënimi 17 deri 23.
- Neni 10. Raporti i ekzekutimit të buxhetit. Shuma e paraqitur në kolonën e buxhetit fillestar në raporte nuk përputhet me shumën e Buxhetit të aprovuar.
- Shënim 30. Harmonizimi në mes ndarjeve buxhetore fillestare dhe përfundimtare. Shënimi i paraqitur nuk është shpalosur si duhet.
- Shënim 12. Të ardhurat vetanake. Shënim 12.1 nuk mund të lidhet me Shënim 12.

#### Të gjeturat në vitin paraprak (vazhdim)

- Neni 13 Shënimi 25 Pasqyra e detyrimeve të faturave të papaguara nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare.
- Neni 15, Shënim 27 Asetet jo-financiare nuk është e kompletuar.
  - Mund të ketë pagesa të konsiderueshme nga palët e treta, (për shembull kur një palë tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë me një pasuri për përdorim nga Komuna), që nuk mund të regjistrohet në pasqyra financiare sepse nuk janë regjistruar në SIMFK;
- Neni 16, Shënimi 29 Detyrimi kontingjent nuk është i kompletuar.

## 2 Menaxhimi i pronave, objekteve dhe pajisjeve

### Të gjeturat

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmëri, përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë mbi patundshmëritë, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Regjistrin vendor për patundshmëri ose në Gjykatë.

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë nga ana e Komunës nuk ka filluar. Megjithëse Komuna ka themeluar në vitin 2009 një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive, ky komitet nuk ka përfunduar ende ndonjë rast dhe si pasojë pasuritë nuk janë regjistruar apo vlerësuar. Komuna nuk ka emëruar ende ndonjë zyrtar për pronat, i cili do të ishte përgjegjës për regjistrin gjatë 2009.

Ne nuk na është ofruar ndonjë evidencë e numërimit të stoqeve të aseteve me 31 Dhjetor 2009 dhe si pasojë verifikimi i regjistrave kontabël me numërimin fizik të pasurisë ishte i pamundur.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Shpalos informacionin mbi pronën, ndërtesat, dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2009 dhe 31 Dhjetor 2008; dhe
- Të sigurojë rikonsilimin e informacionit të regjistruar në regjistrat kontabël me tabelat e vlerësimit apo me ndonjë analizë tjetër, përpara aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

## 3 Të ardhura

### Të gjeturat

- **Sistemi i faturimit.** Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në pronë. Për kategori tjera të të hyrave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm nuk është aplikuar. Me përjashtim të të hyrave nga taksat mbi licencat e bizneseve për të cilat mbahen të dhënat në programin Access, pjesa tjetër e faturimit të Komunës nuk është regjistruar, në vend të saj vetëm arkëtimet e parave nga këto të hyra janë regjistruar.
